



PLANIFIKIMI I INVESTIMEVE KAPITALE NË BASHKINË E POGRADECIT

Qëllimi i projektit

Ky projekt është i fokusuar në përmirësimin e qeverisje vendore në drejtim të rritjes së cilësisë së shërbimeve si dhe rritjes së mirëqenies së qytetarëve duke përzgjedhur investimet prioritare në infrastrukturë që do të ndikojnë dhe në zhvillimin e turizmit në Bashkinë e Pogradecit.

Komponentet e projektit

Komponenti 1: Asistencë në identifikimin e të gjithë aseteve publike lokale që duhet të rehabilitohen, ri-konstruktohen dhe kanë nevojë për investime shtesë si dhe në përcaktimin e intervalit kohor kur duhen kryer dhe alternativave të financimit.

Komponenti 2: Analiza dhe përcaktimi i investimeve kapitale prioritare që reflektojnë kërkesat e qytetarëve në Bashkinë e Pogradecit për zhvillimin e turizmit dhe rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

Komponenti 3: Asistencë në analizën financiare dhe inxhinierike të projekteve kapitale bazuar mbi kostot dhe fizibilitetin financiar të projekteve për të mbuluar një pjesë të kostove të investimit si dhe alternativat e mundshme të financimit duke aplikuar për mbështetje financiare në banka.

Komponenti 4: Asistencë teknike për Bashkinë e Pogradecit në menaxhimin e procesit të plotë të Planifikimit të



Investimeve Kapitale nga këndvështrimi makro si dhe në krijimin një database informacioni që mund të transmetohet dhe adaptohet lehtësisht në situata të ngjashme në të ardhmen.

Rëndësia

Eksperienca e konsiderueshme e URI-t për pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes është një komponent i rëndësishëm në të gjithë hallkat e procesit. Elementi më i rëndësishëm në PIK është

pjesëmarrja e qytetarëve në përcaktimin e investimeve kapitale prioritare si dhe rritja e ndërgjegjësimit të tyre për detyrimet në lidhje me pagesat e taksave dhe tarifave që përbëjnë një ndër pjesët kryesore të buxhetit që do të përdoret për investime kapitale.

FAKTET KRYESORE

PARTNERET:

✓ ARD/USAID

KOHËZGJATIA:

Shkurt 2009 – Prill 2009

PËRFITUESIT:

✓ Bashkia e Pogradecit

KONTAKT:

Zana Vokopola
Drejtoresh Ekzekutive

Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd.14
Hyrja 11, Ap. 56
Tiranë
Tel: +355 4 2256840
E-mail: uri@uri.org.al
Web: www.uri.org.al

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë në kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojmë qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim.. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zviceran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.